




foodconnected

**Lidhja e njerëzve dhe
natyrës rreth
sistemeve ushqimore
të drejta dhe të
qëndrueshme**



SISTEMET USHQIMORE

ANEMBANË GLOBIT SHKAKTOJNË:



Përveç formësimit të kulturës sonë, ushqimi është një aspekt themelor i sigurisë ushqimore dhe përfaqëson një burim të rëndësishëm të ardhurash dhe të punësimit, duke mbështetur ekzistencën në shumë rajone.

Megjithatë, disa faktorë kanë çuar në menaxhimin e dobët të burimeve dhe metodat e prodhimit të dëmshme për mjedisin. Këto janë:

Zinxhirë të gjata, të padrejta dhe të padukshme vlerash

Intensifikimi i prodhimit

Përqendrimi i burimeve në duar të më pak pronarësh

Marketingu i një numri të reduktuar të varieteteve

Këto aspekte kërcënojnë shëndetin tonë dhe shëndetin e ekosistemeve dhe çojnë në humbjen e sistemeve të vogla të prodhimit, njohurive të tyre tradicionale dhe qëndrueshmërisë së komuniteteve lokale.

DISFUNKSIONALITET E SISTEMEVE USHQIMORE

11%

të popullsisë botërore vuan nga kequshqyerja kronike⁴

2 miliardë

të të rriturve janë mbipeshë ose obezë⁴

1/3

e ushqimit të prodhuar në botë për konsum njerëzor hidhen si mbeturina çdo vit¹

936 miliardë dollarë

Shuma prej 936 miliardë dollarë humbet për çdo vit si mbetje ushqimore⁵

¹ FAO, 2011 ² IPCC, 2019 ³ Mailhes dhe Galli, 2017 ⁴ BCFN, 2016 ⁵ FAO, 2013

Sistemet e qëndrueshme dhe të drejta të ushqimit janë të mundshme dhe urgjentisht duhet të promovohen, duke mbështetur sistemet e prodhimit në shkallë të vogël dhe duke shkurtuar distancën midis prodhuesve dhe konsumatorëve përmes zinxhirëve të shkurtra të vlerës që mbështesin edhe natyrën edhe njerëzit.

QASJA E FOODNECTED-IT

KOMUNITETET E PRAKTIKËS SË TË FOODNECTED-IT formojnë një grup të organizuar prodhuesish të vegjël dhe aktorëve të tjerë kyç të sistemit ushqimor, si p.sh.



Ne ndajmë vlerat dhe qasjen ndaj qëndrueshmërisë dhe kemi objektivin e përbashkët për të transformuar sistemin aktual të ushqimit në një sistem të drejtë dhe më të qëndrueshëm në mënyrë që të kemi një planet të shëndetshëm dhe komunitete rezistente. Deri sa i përforcojmë marrëdhëniet tona, ne përmirësojmë aftësitë dhe mësojmë nga përvojat e njëri-tjetrit.

VLERAT THELBËSORE

TË GJITHË ANËTARËT E KOMUNITETIT TË PRAKTIKËS
PAJTOHEN QË SISTEMET E ARDHSHME USHQIMORE DUHET TË SIGUROJNË:

Sovranitetin ushqimorë, cilësinë dhe shëndetin

Njerëzit si tani ashtu edhe në të ardhmen e gëzojnë qasjen në ushqime me cilësi të lartë ushqyese, ndërkohë që plotësojnë nevojat ushqyese për një jetë të shëndetshme dhe për të nxitur mirëqenien.

Zhvillimi lokal, qeverisja gjithëpërfshirëse dhe kohezioni social

Sistemet ushqimore inkurajojnë zhvillimin lokal, roli i grave vlerësohet dhe brezat e rinj inkurajohen të jenë më aktivë në sipërmarrje. Kjo kërkon modele të reja të menaxhimit që i përfshijnë të gjithë aktorët lokalë.

Ndikim i ulët mjedisor

Sistemet e drejta dhe të qëndrueshme të ushqimit u japin përparësi metodave lokale të prodhimit me ndikim të ulët që nuk dëmtojnë mjedisin.



Jetesa dhe tregtia e drejtë dhe e ndershme

Sigurimi i ushqimit sjellë kthime të drejta ekonomike tek prodhuesit dhe inkurajon qëndrueshmërinë e komuniteteve të tyre. Zinxhirët e furnizimit janë të shkurtra dhe transparente.

Njohuritë tradicionale ekologjike

Sistemet ushqimore ruajnë njohuritë e marra nga vendasit gjatë qindra apo mijëra viteve nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me mjedisin. Ato njihen si njohuritë komplementare e njohurive shkencore.



Projekti kryhet në një sërë pilot lokacioneve të ndryshme: **Katalonja**, **Ishujt Baleare** (Spanjë), **Sicilia** (Itali), **Ulqini** (Mali i Zi) dhe zonat tradicionale të blegtorëve nomadë **Sarıkeçili** në malet Taurus dhe shpatet e tij (Turqi).

PILOT LOKACIONET



Duke mësuar më shumë rreth nismave të qëndrueshme në të gjithë rajonin, aktorët lokalë mbështeten në krijimin e zgjidhjeve të mundshme alternative për të rritur qëndrueshmërinë ekonomike të bizneseve të veta duke ulur gjithashtu ndikimin e tyre ndaj planetit. Foodnected do të monitorojë zbatimin e vlerave thelbësore dhe do të veprojë si organ garantues për P2P, do të ofrojë dukshmëri më të madhe për nismat e anëtarëve të vetë, do të ndajë njohuritë mes profesionistëve dhe do të bashkë-zhvillojë zgjidhje për sfidat e përbashkëta.



PARTNERËT

Slow Food është një organizatë globale profesionale e themeluar për të parandaluar zhdukjen e kulturave ushqimore lokale, për të kundërshtuar hovin e jetës së shpejtë dhe për të luftuar interesimin gjithnjë e më të pakët të njerëzve për ushqimin që konsumojnë. Slow Food merr përsipër koordinimin e të gjithë projektit. www.slowfood.com



Slow Food®



Global Footprint Network
Advancing the Science of Sustainability

Global Footprint Network është një organizatë ndërkombëtare e qëndrueshmërisë që po ndihmon botën të jetojë brenda mundësive të Tokës. Global Footprint Network sjell ekspertizë mbi përdorimin e burimeve të Tokës për të ndihmuar të gjithë aktorët e përfshirë në sistemet ushqimore që t'i kuptojnë ndikimin e veprimeve të veta. www.footprintnetwork.org



Low Impact Fishers of Europe përfaqësojnë 10,000 peshkatarë të vegjël të angazhuar për të peshkuar në një mënyrë me ndikim të ulët. LIFE po punon në terren, merr përsipër aktivitetet e komunikimit të projektit dhe është përgjegjës për punën e avokimit për të shpërndarë leksionet e nxjerra në pilot lokacione. www.lifeplatform.eu



GOB Menorca synon të arrijë një ekonomi vërtet të qëndrueshme duke i bërë aktivitetet njerëzore të pajtueshme me ruajtjen e mjedisit. GOB Menorca po vepron si një pilot lokacion, duke integruar rrjetin e fermerëve "Custòdia Agrària" dhe skemën e administrimit të tokës në zhvillimin e Komunitetit të praktikave. www.gobmenorca.com



Misioni i Qendrës për vëzhgimin e shpendëve (CZIP) është mbrojtja e shpendëve dhe specieve të tjera të kafshëve dhe bimëve, habitateve të tyre, monitorimi i biodiversitetit të Malit të Zi, edukimi i qytetarëve, popullarizimi i kërkimit shkencor, si dhe bashkëpunimi me organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit, që merren me mbrojtjen e natyrës. www.czip.me



Shoqata Dr Martin Schneider-Jacoby synon të rrisë ndërgjegjësimin për ruajtjen dhe mbrojtjen e Kripores së Ulqinit, si një pjesë kyçe e biodiversitetit të Malit të Zi. www.msja.me



Alliance for
Mediterranean
Nature & Culture

AMNC është një grup OJQ-sh që punojnë për të ruajtur peizazhet dhe praktikatat tradicionale kulturore që ato i ruajnë. Ajo po sjell leksione dhe përvoja nga pilot lokacionet e veta për zhvillimin e mëtejshëm të mjeteve dhe mekanizmave të Foodnected duke përfshirë skemat e monitorimit të biodiversitetit. www.mednatureculture.org



Yolda punon për ruajtjen e biodiversitetit me fokus në vlerën e praktikave tradicionale kulturore. Yolda merr rolin e integritetit të tokave tradicionale të blegtorëve nomadë Sankeçili në malet e Taurit dhe shpateve të tij dhe lehtësimin e angazhimit të AMNC-së si koordinatorit. www.yolda.org.tr



MAVA ruan biodiversitetin për të mirën e njerëzve dhe natyrës duke financuar, mobilizuar dhe përfurcuar partnerët e vetë dhe komunitetin. MAVA financon drejtpërdrejt projektin. www.mava-foundation.org



foodnected

Foodnected synon që të lidhin njerëzit dhe natyrën rreth sistemeve ushqimore lokale, të drejta dhe të qëndrueshme.

Pavarësisht nëse jeni konsumator apo prodhues, zgjedhjet tuaja individuale mund të kenë një ndikim pozitiv në sistemin global të ushqimit. Le të bëjmë një ndryshim së bashku, bashkohu me komunitetin Foodnected!

 Vizitoni faqen tonë të internetit dhe ndiqni udhëzimet për t'u regjistruar.

www.foodnected.org

info@foodnected.org